



KUVENDI

Bazuar në nenet 12 paragrafi 12.2 shkronja d, dhe 14 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 15 paragrafi 15.2 shkronja d, dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, nenit 11 të Rregullores për caktimin e kriteve për dhënie të shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, nr.01-463-45840 të datës 27 maj 2014, sipas rekomandimit të datës 15 mars 2016 të Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në fshatin Balloc të ngritur me vendim të Kuvendit të Komunës nr.01-005-32384 të datës 10 prill 2014, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2016, miratoi,

VENDIM

PËR LEJIMIN E SHITJES SË OBJEKTEVE TË BANIMIT - KONTEJNERËVE TË TIPIT MONTAZH NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË FSHATIN BALLOC

Neni 1

Lejohet shitja e objekteve të banimit – kontejnerëve, në pronësi të Komunës, të tipit montazh nr. 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

Shitja bëhet, në pako, përmes procedurave të ankandit publik, me çmim fillestar prej 8,500.00 €.

Neni 2

Shitja e objekteve sipas këtij vendimi bëhet me qëllim të lirit të hapësirës në funksion të implementimit të Memorandumit të bashkëpunimit, të lidhur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Podujevës për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, përkatësisht vazhdimin e projektit për largimin e objekteve të banimit – kontejnerëve dhe sistemimin e të gjitha familjeve në shtëpitë që do të ndërtohen në fazat vijuese.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Departamenti i Prokurimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-27817
Podujevë
30 mars 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi